2.7.1 Upgrade të dy serverave ekzistues Dell PowerEdge R940

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade të kapacitetit të memorjes RAM për dy serverat ekzistues Dell PowerEdge R940.

Service tag te serverave ekzistues: 8VTBFV2; 8VT9FV2

- Memorje RAM 32 GB me frekuence 2933MhZ.
- 36 module per secilin server
- Garancia per support duhet te ofrohet nga prodhuesi, ose partneri i autorizuar per sherbime nga prodhuesi per nje periudhe 1 vjecare ne nivelin 24 ore ne dite ne 7 dite te javes.

2.7.2 Upgrade të dy serverave ekzistues Dell PowerEdge R940

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade të kapacitetit të memorjes RAM për dy serverat ekzistues Dell PowerEdge R940.

Service tag te serverave ekzistues: DYSCMF3, CYSCMF3

- Memorje RAM 64 GB me frekuence 3200MhZ.
- 24 module per secilin server

3. INFRASTRUKTURA NETWORK & DATACENTER SITE TIRANA

3.1 STORAGE NVME.

KARAKTERISTIKAT MINIMALE TEKNIKE	
Përshkrimi	Specifikimet
Arkitektura e Storage	<p>Sistemi duhet të ketë arkitekturë all-flash high-end me kontrollera active-active me shasi 2 HU.</p> <p>Sistemi nuk duhet të lejojë arkitekturë Active-Passive apo Active-Standby ne Back-End.</p> <p>Sistemi duhet të jetë një platformë dinamike all-flash që ofron ruajtjen e të dhënave, performancë, efikasitet dhe thjeshtësi në zgjerim.</p> <p>Sistemi duhet të ofrojë zgjerueshmëri me NAS Storage vetëm duket shtuar ndërfaqe ethernet, pa qenë nevoja e licencave shtesë, pajisjeve ndërmjetëse apo kontrollera të jashtëm.</p> <p>Sistemi duhet të ketë katër procesorë intel xeon dhe minimumi 40 core për appliance.</p> <p>Sistemi duhet të ofrojë duplikim (redundancë) për të gjithë hardware pa pikë të vetme deshtimi, të jetë rezistente ndaj dështimeve të një power supply, kontrolleri, drive apo kabëll.</p> <p>Sistemi duhet të suportoje “non-disruptive system” gjatë upgrade të software dhe hardware.</p> <p>Sistemi duhet të ketë kontrollera, të cilet si pjese përbërëse të tyre të kenë edhe bateri për të furnizuar ato gjatë një fataliteti të furnizimit me energji.</p> <p>Memorja cache duhet të ruhet në disqe të dedikuara NVMe për të arritur mbrojtjen e dhe disponueshmerinë më të mirë të mundshme të të dhënave.</p> <p>Sistemi duhet të ofroje nivel të larte të disponueshmerise, të integritetit dhe mbrojtjes se të të dhënave.</p>
Memorja	Sistemi duhet të ofrojë minimum 384Gb cache për appliance.
Kapaciteti dhe zgjerueshmëria	<p>Sistemi duhet të ofroje zgjerueshmëri në shumë dimensione si në shtimin e disqeve dhe në shtimin e kontrollerave llogjike.</p> <p>Sistemi duhet të jetë i zgjerueshëm duke shtuar shelf me disqe NVMe</p> <p>Sistemi duhet të jete i zgjerueshëm deri ne 8 kontrollera active/active me minimumi 384GB memorje secili. Sistemi të jetë i zgjerueshëm të paktën 1.5Tb</p>

	<p>Sistemi nuk duhet të jete i limituar në përdorimin e memories në metodologjinë e shkrimit apo leximit.</p> <p>Sistemi duhet të perdorë disqe te industrise TLC NAND me kapacitet të madh të tipit NVMe SSD (3.84TB, 7.68TB dhe 15.36TB) si edhe miksim të tyre duke patur në dispozicion kapacitetin maksimal të disponueshëm edhe nëse shtohet një disk i vetëm.</p> <p>Sistemi të suportojë minimumi 25 NVMe drive.</p> <p>Sistemi të suportojë minimum NVMe SCM (Storage Class Memory) drive për appliance, të cilat mund të përdoren për të ruajtur të dhenat.</p> <p>Sistemi duhet të ketë të paktën 80 TB kapacitet RAW me të paktën 20 disqe standarde të industrisë NVMe TLC NAND (SED, FIPS 140-2).</p> <p>Sistemi duhet të sigurojë të paktën 60TB kapacitet të mbrojtur (pas RAID) me mbrojtje kundër dy dështimeve të njëkohshme të disqeve.</p> <p>Sistemi duhet të ofrojë të paktën 240 TB kapacitet efektiv pas kompresimit dhe deduplikimit, kjo duhet të garantohet nga prodhuesi.</p> <p>Sistemi të jetë në gjendje të zgjerohet të paktën 1 PB duke shtuar vetëm disqe dhe shelf me disqe.</p> <p>Sistemi duhet të mbështesë përmirësimin e kontrollorëve në modele më të reja (pa ndërprerje), pa ndryshuar shasinë kryesore.</p> <p>Sistemi duhet të monitoroje ne menyre automatike statusin e drive-e, si edhe të caktojë në menyre automatike kapacitetin e papërdorur për të plotësuar hapësirat e lira dhe për t'u mbrojtur nga dështimet e shumta.</p> <p>Sistemi duhet të ndryshojë në mënyrë inteligjente shpejtësinë e rindërtimit bazuar në trafikun e ardhshëm duke ruajtur disponueshmërinë.</p>
Komunikimi	<p>Storage i ofruar të ketë të paktën një port menaxhimi për controller, për grupin e menaxhimit nga jashtë.</p> <p>Sistemi duhet të përfshijë minimumi 4 porta 10/25GbE dhe minimumi 8 porta 32Gb FC për controller. Në zgjidhje duhet të jenë të përfshirë minimumi 8 module SFP+ 10GbE dhe 16 module SFP 32 Gb FC për fiber multimode.</p> <p>Sistemi duhet të jete i zgjerueshëm në të paktën 64 porta FC me suport NVMe (shpejtësi 32GB) dhe/ ose 96 porta ethernet/iSCSI (shpejtësi 25 GB).</p>

	<p>Sistemi duhet të mbështesë protokollet si: FC, NVMe FC, iSCSI, CIFS (SMB 1), SMB 2, SMB 3 dhe më lart, NFSv3 dhe më lart, FTP, SFTP dhe vVols 2.0.</p> <p>Sistemi duhet të ketë të përfshirë licencat për të gjithë protokollet e lartpërmendur.</p>
Sistemi i Operimit	<p>Sistemi duhet të suportojë mjedise të ndryshme të virtualizuara apo aplikacionesh si VMware, MS Hyper-V, Windows, Linux, AIX, Oracle, SAP S4/HANA, MS Exchange, MS SQL.</p> <p>Sistemi duhet të jetë fleksibel për të adresuar një gamë të gjerë të aplikacioneve apo nevojave të institucionit, përfshirë të dhëna të strukturuar apo të pastrukturura si: databaza, e-mail, dokumente, video apo volume për mjedise të përcaktuara.</p> <p>Sistemi duhet të ofrojë hapësirë të konsoliduar për të ndarë të dhënat e ruajtura, për të rritur mundësinë e shfrytëzimit të tyre si edhe për të menaxhuar sa më thjesht ato.</p> <p>Sistemi duhet të suportojë funksionalitetin distributied sparing për të rindërtuar me shpejtësi një drive si edhe zgjerimin e një pool me një drive të vetëm.</p> <p>Sistemi duhet ta ofrojë kapacitetin në dy mënyra:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) kapacitet të përdorshëm pas aplikimit të RAID, b) kapacitet efektiv duke përfshirë: data reduction, compression, deduplication. <p>Sistemi duhet të suportojë in-line compression/deduplication për kapacitetin maksimal efektiv dhe nuk duhet të lejojë post-process compression/deduplication.</p> <p>Kompresimi dhe deduplikimi duhet të funksionojë për të gjitha tipet e drive dhe të jetë efikas për të gjitha strukturat e ruajtura të dhënave.</p> <p>Sistemi duhet të suportojë plotësisht funksionin thin provisioning</p> <p>Sistemi duhet të përfshijë licencën për gjithë kapacitetin e storage për funksionin thin provisioning.</p> <p>Sistemi duhet të suportojë plotësisht integrimin me mjedise virtuale të serverëve, duke ofruar tool për menaxhimin dhe monitorimin e tij.</p> <p>Sistemi duhet të suportojë integrim nativ me mjedise VMware, duke përdorur tool si VAAI, VASA dhe të caktojë funksione VMware si: storage deployment, cloning/snap, vMotion të sistemit storage.</p> <p>Sistemi duhet të suportojë lëvizjen e drejtpërdrejtë të të dhënave midis sistemeve storage, pa qenë nevoja e licencave shtesë për të</p>

	<p>lejuar vendosjen e të dhënave në mënyrën më të mirë të mundshme, bazuar në workload online dhe pa ndërprerje.</p> <p>Sistemi duhet të ofrojë menaxhim të kopjeve të të dhënave për VMware, Oracle, MS SQL.</p> <p>Sistemi duhet të përfshijë licencën për të gjithë kapacitetin e suportuar të storage te ofruar. Licenca nuk duhet të jetë e limituar bazuar në kapacitetin e ofruar.</p> <p>Sistemi të ofrojë licensim të software për të gjithë storage në tërësi dhe të mos jetë e limituar për kapacitet.</p> <p>Sistemi duhet të përfshijë licensim për të gjitha funksionet e ofruara si: volume clustering, replication, snapshots, clones, application consistent snapshots and clones, monitorim dhe raportim.</p>
Menaxhimi	<p>Sistemi duhet të ketë mundësi monitorimi dhe menaxhimi nepermjet GUI, CLI dhe RestAPI.</p> <p>Sistemi duhet të suportoje vmware vRO, CSI plugin for kubernetes, ansible playbooks.</p> <p>Sistemi duhet të suportoje monitorim të performancës në cloud (Latency, IOPS, Read/Write, Bandwidth, IO Size, Queue Length), kapacitet (Total, Savings - Compression, Deduplication, Thin, Snapshots), të ketë mundësi konfigurimi për të dërguar njoftime në një adrese email, të ketë mundësi qasjeje nga pajisje mobile, nëpërmjet aplikacionit të vetë prodhuesve (Android apo iOS).</p> <p>Platforma cloud duhet të jetë e hostuar në mjedisin e vet prodhuesit, pa kosto shtesë për të gjithë periudhën që sistemi i propozuar do të jetë në support dhe të ofrojë historik të të dhënave për të paktën një periudhë 1 vjeçare.</p>
Siguria	<p>Sistemi duhet të ofrojë siguri maksimale të informacionit dhe të minimizojë riskun e dështimit, humbjes së të dhënave, korruptimin e të dhënave, aksesin e paautorizuar.</p> <p>Sistemi duhet të mbështetë standarte për sigurinë Data Rest Encryption, Fips 140-2, Native sha-2, tls 1.2.</p> <p>Sistemi duhet të pranojë vetëm disqe të certifikuar me standartet FIPS 140-2 Niveli 2.</p> <p>Sistemi duhet të ofrojë enkriptim në kontrollor.</p> <p>RBAC dhe autentikimi i shumëfishtë duhet të jetë të disponueshme.</p> <p>Sistemi duhet të suportoje arkivim të log-eve të auditimit për të paktën një periudhë prej 180 ditësh.</p>

<p>Mbrojtje lokale dhe remote</p>	<p>Sistemi duhet të mbështetë të paktën replikim asinkron dydrejtimësh në distancë mbi IP me mundësi: "1:1", "1:n", dhe "n:1".</p> <p>Sistemi cluster Active-Active të ketë mundësi të krijohet bazuar në LUN-e/volume. Mundësia e shtimit të një site të tretë për replikim duhet të suportohet.</p> <p>Sistemi duhet të përfshijë skenar Active/Active, duke lejuar shkrimin e të dhënave në të dy sitet (LUN/Volume) pa vonesë (RPO=0, RTO=0).</p> <p>Sistemi duhet të ndërtohet me arkitekturë mbrojtjeje dhe rikthim edhe nëse site i tretë nuk ekziston.</p> <p>Nëse aktivizimi i replikimit kërkon rezervim të kapacitetit shtesë, prodhuesi duhet të sigurojë jo më pak se 30% të kapacitetit shtesë të përdorshëm në konfigurimin e ofruar.</p> <p>Sistemi duhet të suportojë mbrojtje lokale: Snapshot, Thin Clones, SED Based Encryption, AppSync.</p> <p>Sistemi duhet të suportojë splication consistency copies me replikim local dhe në distancë.</p>
<p>AC Power</p>	<p>Sistemi të ofrojë redundant power supply 200-240 VAC, 50Hz.</p>
<p>Montimi në Rack</p>	<p>Sistemi të jete i montueshëm në rack, duke përfshirë dhe aksesorët e montimit.</p>
<p>Kabllo FC</p>	<p>Sistemi duhet të ketë të përfshirë kabujt fibër dhe kabujt e ushqimit.</p>
<p>Performanca</p>	<p>Sistemi të trajtojë të paktën tipe te ngarkesave të të dhënave si: vdbench, DRR turned on everywhere, 0% cache hits, 100% random access, pre-written array.</p> <p>snapshot sipas teknologjisë rirect-on-write.</p> <p>120.000 IOPS 70/30 R/W 8KiB madhësi IO me më pak se 0,9 ms kohë përgjigjeje.</p> <p>të paktën 100.000 IOPS 70/30 R/W 8KiB madhësia IO me një kontrollor në gjendje mosfunktionimi ose gjatë përmirësimeve të rekomanduara nga prodhuesi.</p> <p>Madhësia IO 2,5 GiB/s 70/30 R/W 64 KiB me më pak se 1 ms kohë përgjigjeje.</p> <p>Sistemi storage duhet të përfshijë një platformë metro cluster të automatizuar për business continuity midis dy site HQ-site sekondar.</p> <p>Platforma duhet të ofrojë numra të dyfishuar të IOPS për volume të njëjta në të dy sitet, ku vdbench të funksionojë në te dy sitet.</p>

	<p>Platforma duhet të mbështetë specififikimet hardware minimale si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Minimumi 16 core total - Minimumi 64Gb memorie - Minimumi 800GB SDD capacity - Minimumi 8 porta FC 32GB - Minimumi 4 port 10Gb ethernet - Burime ushqimi redundante 1400 WAT <p>Platforma të jetë e licensuar për të gjithë kapacitetin e ofruar /suportuar me sistemin storage NVMe.</p>
Garancia	Garancia të ofrohet nga prodhuesi apo partneri i autorizuar për një periudhë 3 vjeçare suportit me nivel shërbimi 24 x 7 me akses në qendrën e shërbimeve të prodhuesit për hardware dhe software.

3.2 CORE SWITCH.

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Ndërfaqet dhe karakteristikat hardware	
Porta fikse 1/10Gbps SFP+	24
Module të përfshira të licensuara SFP+, 10GB distancë të vogël multimode LC	24
Module të përfshira të licensuara SFP+, 10GB distancë të madhe multimode LC	2
Porta Console 10/100/1000	Po
Porte seriale RS-232	Po
Porte USB	Po
Instalimi në Rack	19'' Rack Mountable
HYRJE "INPUT"	
Tensioni Nominal	100~240 V AC

Frekuenca	50/60 Hz
PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI	
Switching Capacity	≥ 960 Gbps
Throughput	≥ 620 Mpps
Flash Memory	16 Gb
RAM	16 Gb
Jumbo Frame	9k
Tabelë të Adresave MAC	64k
VLAN	4096
Hot-Swappable fan redundante	Po
Hot-Swappable PSU redundante	Po
STANDARDET	
IEEE 802.1ab	Po
IEEE802.3z	Po
IEEE 802.3ad	Po
IEEE 802.3ae	Po
IEEE 802.1d	Po
IEEE 802.1s	Po
IEEE 802.1w	Po

IEEE 802.1q	Po
IEEE 802.1p	Po
IEEE 802.1ax	Po
IEEE 802.3ba	Po
CISPR 22 Class A	Po
VCCI Class A	Po
EN55024	Po
RoHS	Po
IEC 60950-1, EN 60950-1	Po
CSA C22.2 No. 60950-1	Po
FCC Part 15 Class A	Po
SISTEMI OPERATIV	
Të jetë i orientuar për Operacionet LAN, Datacenter	Po
Të ketë mundësi për Upgrade	Po
LAYER 2/LAYER3	
Funksionalitete	Layer 2 switch port, Layer 3 switch port, VLAN trunk, Inter-VLAN Routing Rapid Spanning Tree Protocol, Spanning Tree Protocol guard Flow Control. Static routes, (RIPv2), ACL, OSPFv2,

	Virtual Router Redundancy Protocol, Storm control (multicast, broadcast) Multicast (PIM-SM), Source-Specific Multicast, Multicast Source Discovery Protocol
SIGURIA	
Access Control List	Po
TCP/UDP Ports	Po
VLAN base	Po
Port Base	Po
MENAXHIMI	
CLI	Po
RJ-45 Console	Po
Telnet, SSH	Po
USB Storage	Po
Authentication	RADIUS, TACACS+, AAA, SSH v1/v2,
Standard enkriptimi AES	Po
LED	Po
SNMP v1/v2c/v3	Po
SYSLOG	Po
Licensimi	Të jetë i përfshirë me pajisjen për të gjitha portat.

Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit
---	-------

3.3 SWITCH I MENAXHUESHËM ME 48 PORTA.

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Ndërfaqet dhe karakteristikat hardware	
Porta 10/100/1000Mbps RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX)	48
Porta SFP+	4 porta 10 Gb Ethernet, dy module multimode 10GB me distancë të shkurtër të përfshirë.
Porta Console RJ-45/mini usb	1
Instalimi në Rack	19’’ Rack Mountable
HYRJE "INPUT"	
Tensioni Nominal	110~240 V AC
Frekuenca	50/60 Hz
PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI	
Switching Capacity	≥ 176 Gbps
Throughput	≥ 130 Mpps
Flash Memory	4 GB
RAM	2 GB
Jumbo Frame	9k

Tabelë të Adresave MAC	16k
Fan	Opsionale
PoE+	Opsionale
STANDARDET	
IEEE 802.3 - 10BASE-T	Po
IEEE 802.3u - 100BASE-T	Po
IEEE 802.3ab - 1000BASE-T	Po
IEEE802.3z - 1000BASE-X	Po
IEEE 802.3ad - Agregim linku	Po
IEEE 802.3x - full duplex on 10BASE-T, 100BASE-TX, and 1000BASE-T ports	Po
IEEE 802.1d - Spanning Tree Protocol	Po
IEEE 802.1s - multi STP	Po
IEEE 802.1w - RSTP	Po
IEEE 802.1q - VLAN	Po
IEEE 802.1x - Port-based Network Access Control	Po
IEEE 802.1p - QoS Classification	Po
IEEE 802.3af - PoE	opsionale
IEEE 802.3at - PoE	opsionale

SISTEMI OPERATIV	
Të jetë i orientuar për operacionet LAN	Po
Të ketë kundësi për upgrade	Po
QUALITY OF SERVICE	
Priority Queues	Po
Queue Scheduling	WTD, SRR
VEÇORITË	
IGMP Snooping	V1/V2
Spanning Tree	STP/RSTP/MSTP
LLDP	Po
BPDU Filtering/Guard	Po
802.3x	Po
VLAN	4k, (Voice VLAN Opsional)
Agregim të Linkeve	802.3ad LACP
Adresimi IPv6	Po
Limitim të Shpejtësisë	Port/Flow
Policy-Based Routing (PBR)	Jo
Routimi	Jo
SIGURIA	

Access Control List	Po
TCP/UDP Ports	Po
Protokollin DSCP	Po
Authentication	RADIUS, IEEE 802.1X, Port/MAC, SSH v1/v2, CLI, web GUI
Storm Control	Broadcast, Multicast, Unicast
MENAXHIMI	
Web-based GUI dhe CLI	Po
Mini USB / RJ-45 Console	Po
Telnet, SSH	Po
USB Storage	Po
Monitorim të CPU	Po
Upgrade të Firmware	TFTP ose ndërfaqes Web
Ekran LED	Opsionale
SNMP v1/v2c/v3	Po
SYSLOG	Po
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	3 Vite

3.4 UPGRADE I ACCESS SWITCH.

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade të Access Switcheve Cisco Catalyst 9200 me module SFP+ Long Range.

- Kater Module SFP+ Long Range me Part number: SFP-10G-LR-S.
- Garancia 1 vit.
- Produktet të jenë origjinale të vendorit përkatës.

3.5 UPGRADE I CORE FIREWALL.

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade të Firewall Checkpoint Security Gateway me produktet si më poshtë:

Pajisja fizike e Checkpoint Security Gateway: Server HPE ProLiant DL380

- Kater porta SFP+ pcie.
- Dy module SFP+ 10GbE short range.
- Dy module SFP+ 10GbE long range.
- Garancia 1 vit.
- Produktet të jenë origjinale të vendorit përkatës.

3.6 UPGRADE I EDGE FIREWALL.

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade të Firewall Cisco 2130 me produktet si më poshtë:

- Kater Module SFP 1000BASE-LX/LH.
- Garancia 1 vit.
- Produktet të jenë origjinale të vendorit përkatës.

3.7 SERVER RACK.

<i>Modeli i Serverit:</i>
<ul style="list-style-type: none">• Serveri duhet te jete i instalueshëm në rack dhe lartësia e tij nuk duhet të jetë më shumë se 3 HU.• Serveri duhet të suportoje minimumi 8 hard drive.• Serveri duhet të ketë të përfshirë kit për instalimin në rack.• Serveri të ketë të përfshirë çdo kabëll për vendosjen e tij në gjendje pune.• Serveri të suportoje hot plug redundante të sistemit ftohës (fan-ve).• Serveri duhet të ketë të përfshirë dy burime ushqimi.
<i>Modeli i procesorit:</i>
<ul style="list-style-type: none">• Serveri duhet të suportoje katër procesorë me pikë minimalisht 25500, sipas www.cpubenchmark.net.• Serveri duhet të përfshijë të paktën dy (2) procesorë.• Serveri duhet të ketë të përfshirë dy procesorë me të paktën 24 core secili dhe cache jo më të vogël se 30 Mb.
<i>Memorja Ram:</i>
<ul style="list-style-type: none">• Serveri duhet të ketë minimumi 1.5 TB kapacitet RAM.• Serveri duhet të suportoje të paktë 12 module Ram për çdo procesor.
<i>Nderfaqet:</i>

- Serveri duhet të ketë të përfshirë minimalisht 2 porta sfp+ gigabit ethernet me module transceiver të përfshirë për fiber multimode.
- Serveri duhet të ketë të përfshirë të paktën një karte fibër me dy porta minimalisht 16 Gb/sec me module transceiver të përfshirë për fibër multimode.

Menaxhimi:

- Serveri duhet të ketë software për kontroll dhe monitorim në largësi, duke ofruar funksionalitetet e mëposhtme:
- Console menaxhimi në largësi për të aksesuar pajisjen nëpërmjet web browser.
- Të informojë në mënyrë automatike me email administratorin për çdo defekt që mund të ndodhë si: keqfunksionim i drive-ve, moduleve të memorjes, power supply, faneve dhe procesorëve.
- Të ketë mundësi rindezje, fikjeje dhe ndezjeje në largësi të pajisjes (përfshirë dhe boot-im nga drive-e virtuale).
- Konsola virtuale duhet të suportojë funksionalitet gjatë përdorimit të web browser.
- Mundësi të mblësh informacion rreth nivelit të përdorimit të CPU dhe memorjes RAM të serverit pa nevojën e instalimit të agjentëve në sistemin e operimit.
- Mundësi për të menaxhuar kontrollerat e instaluar në brendësi të shasisë së pajisjes, nëpërmjet ndërfaqes web ose ndërfaqes së kontrollerit pa nevojën e instalimit të agjenteve software të sistemit të operimit.
- Mundësi shfaqjeje nëpërmjet ndërfaqes web ose cli për të eksportuar informacion për diagnostifikimin e statusit të pajisjes.
- Të suportojë shkrimin e konfigurimeve të moduleve të kontrollit në një drive të dedikuar i instaluar në brendësi të pajisjes, për të rivendosur statusin e serverit në rastin e ndërrimit të bordit.
- Mundësi për të përdoruar hardware dhe software për përgatitje të instalimit të sistemit operativ (konfigurim të volumeve, krijimin e particioneve, kopjimin e drive-ve, krijimin e file për përgjigje gjatë instalimit të sistemit operativ), të cilat nuk kërkojnë përdorimin e hapësirave në media të jashtme.
- Mundësi për të kryer përditsim të mikrokodeve të komponentëve të pajisjeve nëpërmjet një moduli ndërfaqe menaxhimi dhe përditsim të sistemeve operative të suportuar.
- Paisjet duhet të jenë të reja, të papërdorura, të përfshijnë të gjitha përmirësimet e fundit në dizajn dhe materiale dhe nuk janë deklaruar nga prodhuesi si end of sale ose end of availability .

Garancia

Garancia të ofrohet nga prodhuesi për një periudhë 3 vjeçare suportit me akses në qendrën e shërbimeve të prodhuesit për hardware dhe software.

3.8 WAN ROUTER

Përshkrimi	Specifikimet Minimale
Forwarding Througput	Min 10 Gbps

Throughput Ipv4	Min 3Gbps
Porta WAN or LAN 10GbE	Minimumi 4
Licencim për minimumin e tuneleve IPSEC	500
Porta RJ-45-based	Minimumi 4
Porta SFP+	Minimumi 4
NIM slot	Po
PIM slot	po
RAM	Minimumi 8 Gb
Flash memory	Minimumi 16 Gb
Storage	Opsional
USB 2.0 slots (tipi A)	Minimumi 1
Porta konsole	Minimumi 1
Power-supply	AC
Instalimi në Rack	19'' Rack Mountable
Sesione firewall	512K
Ipv4 routes	800K
Safety	<ul style="list-style-type: none"> - UL 60950-1 - CAN/CSA C22.2 No. 60950-1 - EN 60950-1 - AS/NZS 60950-1

	- IEC 60950-1
EMC	<ul style="list-style-type: none"> - ICES-003 Class A - EN55032 Class A - CISPR32 Class A - AS/NZS CISPR 32 Class A - VCCI V-3 - CNS 13438 - EN 300-386 - EN 61000 (Immunity) - KN32, KN35
Protokollet që suporton	<p>IPv4, IPv6, static routes, Routing Information Protocol Versions 1 and 2 (RIP and RIPv2), Open Shortest Path First (OSPF), Enhanced IGRP (EIGRP), Border Gateway Protocol (BGP), BGP Router Reflector, Intermediate System-to-Intermediate System (IS-IS), Multicast Internet Group Management Protocol Version 3 (IGMPv3), Protocol Independent Multicast sparse mode (PIM SM), PIM Source Specific Multicast (SSM), RSVP, CDP, ERSPAN, IPSLA, Call Home, EEM, IKE, ACL, EVC, DHCP, FR, DNS, LISP, OTV[6], HSRP, RADIUS, AAA, AVC, Distance Vector Multicast Routing Protocol (DVMRP), IPv4-to-IPv6 Multicast, MPLS, Layer 2 and Layer 3 VPN, IP sec, Layer 2 Tunneling Protocol Version 3 (L2TPv3), Bidirectional Forwarding Detection (BFD), IEEE802.1ag, and IEEE802.3ah</p>
Enkapsulimi që suporton	<p>Generic routing encapsulation (GRE), Ethernet, 802.1q VLAN, Point-to-Point Protocol (PPP), Multilink Point-to-Point Protocol (MLPPP), Frame Relay, Multilink Frame Relay (MLFR) (FR.15 and FR.16), High-Level Data Link Control (HDLC), Serial (RS-232, RS-449, X.21, V.35, and EIA-530), and PPP over Ethernet (PPPoE)</p>

Manaxhimi i trafikut	QoS, CBWFQ, WRED, Hierarchical QoS, Policy-Based Routing, Performance Routing dhe NBAR.
Licenca	Po, e pajtueshme per nje periudhe 3 vjecare e cila te kete funksionalitet per: menaxhim i qenderzuar, monitorim, netflow, Macsec-128, analitycs, aplication controll, automatizim dhe provizionim, siguri ne konektivitet. Licensimi te perfshije 50 MB througput total te eknriptuar per keto funksionalitete.
Garancia	1 vit garanci nga prodhuesi për hardware dhe software

3.9 SHËRBIM INSTALIM DHE KONFIGURIMI

Operatori Ekonomik duhet të bëjë instalimin dhe konfigurimet që janë ofruar në këtë prokurim, duke mos shkaktuar down-time (ndërprerje të shërbimeve) në sistemet kryesore të Operatorit Ekonomik.

SHËRBIMET QË DUHET TË KRYHEN

- **Core Switch**

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.
- Aktivizimi i licencave.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit

- **Switch i menaxhueshëm 48 porta.**

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.
- Aktivizimi i licencave.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit

- **Storage NVMe**

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.
- Aktivizimi i licencave.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit

- **Sistem Monitorimi dhe menaxhimi**

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi i software.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.
- Aktivizimi i licencave.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit

- **Upgrade me module SFP**

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi i produkteve që do të bëhet upgrade.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit.

Shërbime Instalimi dhe konfigurimi të software, hardware si dhe verifikimi i garancive për suport për periudhën një vjeçare për gjithë produktet në këtë prokurim.

- Përgatitja e skenarit e detajuar për ndërtimin, instalimin, konfigurimin e shërbimeve.
- Përgatitja e skemave të implementimit.
- Testimi i shërbimeve të implementuara.
- Dokumentimi i çdo instalimi, konfigurimi sistemesh: software, hardware.
- Dokumentimi i suportit, mirëmbajtjes së sistemeve të implementuara.

4. SHERBIME MIRREMBAJTJE/SUPORTI ONSITE DHE REMOTE

OBJEKTIVI I SHËRBIM MIRREMBAJTJE NË VENDNDODHJE DHE NË DISTANCË

OSHEE Group sh.a kërkon shërbim mirëmbajtje onsite/remote për pajisjet ekzistuese aktualisht në gjendje pune dhe pajisjet e reja në mënyrë që problematikat dhe defektet hardware dhe software të mos afektojnë punën. Mirëmbajtja duhet të ofrohet për gjatë gjithë periudhës të përcaktuar në këtë prokurim.

Operatori Ekonomik duhet:

- ✓ Te ketë skuadër të dedikuar për support/mirëmbajtje 24/7, mundësi të qendërimit të thirrjeve dhe të një kontakti të vetëm që do të koordinojë dhe menaxhojë thirrjet e OSHEE Group sh.a.
- ✓ Të pranojë kohë të shpejtë të thirrjes, maksimumi 1 orë nga log-ini i thirrjes së OSHEE Group sh.a.
- ✓ Të bëjë vlerësimin në bazë të natyrës së problemit, nëse ndërhyrja do të bëhet remote apo onsite.
- ✓ Te paraqitet në vendndodhjen e OSHEE Group sh.a. brenda 4 (katër) orëve nga log-ini i thirrjes dhe raportimit të problemit, në rast se thirrja konsiderohet urgjente dhe brenda ditës së nesërme të punës për thirrje jo urgjente.
- ✓ Te kryejë diagnostifikim dhe zgjidhje ne distance/ne vendodhje të problemeve të njoftuara nga personeli i OSHEE Group sh.a..
- ✓ Te ofrojë mirëmbajtje të plotë të hardware-t me zëvendësim falas të pajisjes ose pjesëve të këmbimit në rast defekti.
- ✓ Te ofrojë mirëmbajtje të plotë të software-t duke kryer update të rregulta për gjatë periudhës së mirëmbajtjes.
- ✓ Te ndërrojë pjesë të pajisjeve të dëmtuara, konfigurime dhe rikonfigurime sipas kërkesave të OSHEE Group sh.a..
- ✓ Te bejë diagnostikime proaktive me mbështetje të vendorit dhe hapje case TAC, Update të software-ve të Sistemit të Operimit (OS), duke përfshirë minor, major releases.

Teknikët e shërbimit të Operatori Ekonomik duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndërvepruar në mënyrë të drejtpërdrejtë me prodhuesin. Në rast se do të jetë i nevojshëm zëvendësimi i pjesëve të këmbimit, atëherë Operatori Ekonomik duhet të kryejë të gjitha procedurat respektive me prodhuesin për lokalizimin e pjesës, heqjen, eksportin, transportin, importin, vendosjen dhe rikonfigurimet përkatëse. Kostot e pjesëve të dëmtuara dhe kostot e shërbimit do të merren përsipër nga Operatori Ekonomik për të gjithë periudhën e kontratës.

Nivelet e shërbimit të mirëmbajtjes dhe proceset onsite/remote:

OSHEE Group sh.a kërkon shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar me poshtë:

1. Shërbime në distancë (Remote).

Operatori Ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë intervalit kohor, nga e hëna në të dielë, 24/7, për të ofruar shërbime të mirëmbajtjes parandaluese dhe të riparimit në distancë të raportuara nga personeli i autorizuar OSHEE Group sh.a. Tekniku duhet të koordinohet me personelin e IT të OSHEE Group sh.a, për të siguruar të gjitha akseset e duhura për realizimin e ndërhyrjes. Tekniku duhet të kryejë të gjitha diagnostifikimet e duhura për përcaktimin dhe zgjidhjen e problemit, në rast

se kjo realizohet nëpërmjet ndërhyrjes në distancë, pa afektuar shërbimet e OSHEE Group sh.a. Në rast se problem, nuk mund të zgjidhet në distancë do të adresohet shërbimi në vendndodhje (onsite).

2. Shërbime në vendndodhje (mjediset e OSHEE GROUP sh.a).

Operatori Ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë intervalit kohor, nga e hëna në të dielë, 24/7, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "*Alarmeve Madhore*" të raportuara nga personeli i autorizuar i OSHEE GROUP sh.a ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin *Alarm Madhor* do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për shërbime riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të sistemeve të mbuluara që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëhershme e të konsiderueshme të Sistemit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i OSHEE GROUP sh.a, të rekomanduara nga Operatori Ekonomik.

✓ Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.

OSHEE Group sh.a. duhet të njoftojë me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion nga operatori ekonomik dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Operatori Ekonomik duhet të kontaktojë OSHEE Group sh.a. dhe të konfirmojë marrjen e *Alarmit Madhor*, brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i OSHEE Group sh.a. Në momentin e njohjes së thirrjes nga operatori ekonomik, OSHEE Group sh.a. do të vendosë në dispozicion informacione të paracaktuara në Procedurat e Troubleshooting nga Operatori Ekonomik dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar. OSHEE Group sh.a. bashkepunon me kërkesen e Operatorit Ekonomik për ta ndihmuar, në përcaktimin e shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

✓ Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.

Nëse Operatori Ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting shkakun e Alarmit madhor, atëherë duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë OSHEE Group sh.a, brenda intervalit kohor prej 1 ore nga momenti marrjes së njoftimit për *Alarm Madhor*. Me të mbërritur, tekniku do të mbështetet me asistencë nga OSHEE Group sh.a. dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

✓ Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit.

Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa:

(a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë "zgjidhur në mënyrë të tërthortë";

(b) Tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër;

(c) Operatori Ekonomik të përcaktojë, se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i sistemeve të mbuluara ose

(d) Operatori ekonomik të arrijë në konkluzionin që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

3. Shërbimet e tjera:

Operatori Ekonomik duhet të krijojë/diskutojë me OSHEE GROUP sh.a. një agjendë periodike kontrollesh si më poshtë:

✓ Javore

- a. Kontroll i log-eve të sitemeve te instaluara.
- b. Kontroll i statistikave për datat, aplikimet dhe shërbimet e mbrojtura.
- c. Kontroll i hardware dhe zëvendësimi i pjesëve të defektuara dhe me probleme në rast nevojë.
- d. Të kryejë mirëmbajtje proaktive.

✓ Mujore.

- a. Testim / kontroll i kompletuar i pjesëve me kritike të infrastrukturës.
- b. Kontroll i detajuar i gjithë log-eve hardware / software
- c. Rishikim i të dhënave mbi performancën e serverave dhe aplikimeve që ekzekutohen në to.
- d. Rekomandime për upgrade të mundshme software dhe hardware.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: CyberRecovery (Rinovimi i infrastruktures së datacenter për pajisjet “end of life” në business continuity)

Afatet e ekzekutimit: Instalim, konfigurim dhe implementim brenda 240 diteve nga nënshkrimi i kontratës. Garancia do të jetë 12 muaj pas implementimit.

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrim:

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	GARANCI PËR SUPORT INFRASTUKTURA NETWORK		
1.1	Garanci për Suport për Cisco Switches	vit	1
2	INFRASTUKTURA NETWORK & DATACENTER SITE HQ		
2.1	F.V. Storage NVMe	copë	1
2.2	F.V. Upgrade i Core Switch	Set	1
2.3	F.V. Upgrade i Access Switch	Set	1
2.4	F.V. Upgrade i Core Firewall	Set	1
2.5	F.V. Upgrade i EDGE Firewall	Set	1
2.6	F.V. Software për menaxhimin e pajisjeve dhe monitorimin në kohe reale	Set	1
2.7	F.V Upgrade i Serverave me RAM	Set	1
3	INFRASTUKTURA NETWORK & DATACENTER SITE TIRANA		
3.1	F.V. Storage NVMe	copë	1
3.2	F.V. Core Switch	copë	2
3.3	F.V. Switch i menaxhueshëm me 48 porta	copë	2
3.4	F.V. Upgrade i Access Switch	Set	1
3.5	F.V. Upgrade i Core Firewall	Set	1
3.6	F.V. Upgrade i EDGE Firewall	Set	1
3.7	F.V. Server Rackmount	copë	4

3.8	F.V. WAN Router (DMVPN)	copë	1
4	Dizenjim dhe Implementim i Infrastrukturës		
4.1	Dizenjimi i infrastrukturës	Set	1
4.2	Instalimi i infrastrukturës	Set	1
4.3	Implementimi i infrastrukturës	Set	1
4.4	Krijimi i LUN/Volume	Set	1
4.5	Migrimi i hosteve	Set	1
4.6	Instalimi i cluster-ve	Set	1
4.7	Testimi dhe verifikimi i shërbimeve	Set	1
5	Shërbime Instalimi dhe konfigurime lokale dhe në distancë		
5.1	Konfigurimi i hosteve lokalisht dhe remote në mënyrë që te perceptojne LUN/volume fizik nga ty dy sitet si një i vetëm.	Set	1
5.2	Konfigurimi i lidhjeve në distancë për hostet dhe zgjedhja si preferencial i sistemit që të ruajë aksesimin në rast se ndodh një dështim.	Set	1
5.3	Konfigurimi i hosteve ESXi lokalisht dhe në distancë për lidhjet me dy sistemet në mënyrë që të ofrohet konektivitet metro.	Set	1
5.4	Konfigurimi i I/O të hosteve me sistemet storage.	Set	1
5.5	Konfigurimi dhe vendosja e roleve për LUN/Volume në të dy sitet.	Set	1
5.6	Konfigurimi dhe lëvizshmëria e të dhënave me disponueshmëri të lartë brenda një mjedisi të dhënash.	Set	1
5.7	Konfigurimi dhe lëvizshmëria e të dhënave me disponueshmëri të lartë midis dy mjediseve të dhënash në mënyrë sinkrone.	Set	1
5.8	Konfigurimi dhe integrimi nativ i sistemeve të reja storage me pajisjet ekzistuese Dell Datadomain 6400. Transferimi dhe komunikimi midis tyre të bëhet direkt dhe i enkriptuar.	Set	1
5.9	Konfigurimi i Cisco virtual Port Channel (vPC) në ToR Switcch	Set	1
5.10	Konfigurimi i ToR Switch Cisco Nexus me disponueshmëri të lartë midis dy mjediseve, site primar dhe sekondar	Set	1
5.11	Konfigurimi i Core firewall Checkpoint Security Gateway (firewall i brendshëm) me disponueshmëri të larte midis dy mjediseve, site primar dhe sekondar.	Set	1
5.12	Konfigurimi i Edge firewall Cisco FPR NGFW me disponueshmëri të lartë midis dy mjediseve, site primar dhe sekondar.	Set	1

5.13	Konfigurimi i DMVPN Cisco Routers me disponueshmëri të lartë midis dy mjediseve, site primar dhe sekondar	Set	1
5.14	Konfigurimi me disponueshmëri të lartë midis mjedisit primar dhe sekondar i aksesimit me autentikim të shumëfishtë të sistemit të blerjes së energjisë.	Set	1
5.15	Zhvendosje, instalim, konfigurimi dhe testimi i disaster recovery (site i tretë)	Set	1
6	SHËRBIM MIRËMBAJTJEJE		
6.1	Shërbime Instalimi dhe konfigurimi Onsite	Set	1
6.2	Shërbime Mirëmbajtjeje/Suporti Onsite dhe Remote	vite	1

Dhe referuar Specifikimeve Teknike.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 70,000,000 (Shtatedhjetë milion) leke pa TVSH.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2020, 2021, 2022. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të konfirmuara nga organet perkatëse. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet/produktet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 70,000,000 (Shtatedhjetë milion) leke pa TVSH.

a) Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

-
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:

- a. ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme)
- b. ISO 27001:2013 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme)
- c. ISO/IEC 20000-1:2018 ose ekuivalente (për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

